



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASHKISË SKRAPAR

911  
20.03.2024



Nr. 12 prot.

Çorovodë më: 20.03.2024

**Lënda: Njoftim për mbajtjen e mbledhjes së Këshillit të Bashkisë Skrapar**

**I nderuar Këshilltar,**

Ju njoftoj se ditën e mërkurë më datë 27.03.2024, ora 11<sup>00</sup>, në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Bashkisë Skrapar, Qendra Kulturore "Riza Cerova" Kati i Dytë, zhvillohet mbledhja e radhës e Këshillit të Bashkisë Skrapar, e thirrur nga Kryetare e Këshillit në zbatim të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, neni 53, pika 4, me këtë rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 27.02.2024.
3. Projektvendim, "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi kushtëzuar për muajin Shkurt 2024".
4. Projektvendim, "Për dhënien e ndihmës financiare nga Bashkia Skrapar për shtetasen Anila Duro".
5. Projektvendim, "Për miratimin e tavaneve përgatitore të PBA-ë, 2025-2027".
6. Projektvendim, "Për miratimin e dhënies së bursës nga buxheti Bashkisë Skrapar, nxënëses Krisilda Babaliu, për vitin shkollor 2023-2024".
7. Projektvendim, "Dhënien e pëlqimit, për nënshkrimin e marrëveshjes së binjakëzimit midis Bashkisë Skrapar dhe Bashkisë Irsina, Provinca Madera Itali".
8. Projektvendim, "Për akordimin e fondeve buxhetore për projektin "100 Personalitetet më të spikatura të Skraparit".
9. Të ndryshme.

**KRYETARE KËSHILLIT BASHKIAK  
Elsa PETRITAJ**

